REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr.5099/1 Prot. Lushnje, më 17/06/2025

PROJEKT - VENDIM

NR. 47 DATË 17/06/2025

PËR NJË SHTESË NË VKB-NË NR 02 DATË 23/01/ 2025 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA, QË BANOJNË ME QIRA NË TREGUN E LIRË DHE NUK KANË TË ARDHURA TË MJAFTUESHME PËR TA PËRBALLUAR VETË GJITHË VLERËN E QIRASË"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___/___/2025 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga zyra e Strehimi dhe në zbatim të nenit 24, nenit 54 të ligjit Nr: 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social", kreu V neni 33, 34, 35, 38, dhe të VKM Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM Nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin" dhe të VKB Nr.90 datë 23.11.2024 "Mbi miratimin e sisitemit të pikëzimit për programin Subvencionimi i Qirasë "Këshilli Bashkiak:

PROPOZOJMË :

1. Të miratojë listën e subvencionimit të qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kan të ardhura të mjaftueshme për ta përballuar vetë gjithë vleren e qirasë për periudhën Qershor - Dhjetor 2024, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Strehimit dhe Drejtoria e Financë- Buxhetit.
3. Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Drejtoria Shërbimit Social

Anila Cela

P. J-Pirra

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa